



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 4281 Prot.

Tiranë më, 16.12.2021

VENDIM

Nr. 15, datë 16.12 2021

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR
VENDIN E PUNËS PËR PERSONEL NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER
ADMINISTRATIV, NË REKTORATIN E UT-SË**

Sot, në datën 16.12. 2021, bazuar në nenin 66, pika 3, 4, të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015; në nenin 80, pika 1, 2, 7, të Statutit të UT-së; në propozimin e kriterëve të veçanta të njësisë ku personeli ndihmësakademik me karakter administrativ do të shërbejë, sipas strukturës organizative të miratuar të Rektoratit të UT-së; në përshkrimin e pozicionit të punës; Rektorati i UT-së, në mbledhjen e tij të datës 16.12 2021, pasi mori në shqyrtim kriteret e propozuara,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e punësimit sipas Lidhjes nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në Rektoratin e UT-së, për vendin e punës, "Specialist" në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky Vendim, së bashku me Lidhjen nr.1 të tij, i përcillet Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme në Rektoratin e UT-së, për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha
